REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNAL-SHTIME

01Nr. 06/11787, Datë: 10.09.2013

Npi – 01/204, Datë: 18.09.2013

# S t r a t e gj i a
# për Zhvillim Ekonomik Lokal
# 2014 - 2018

Shtator, 2013

# KOMUNA SHTIME

## NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Komuna Shtime gjendet në pjesën qëndrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,324 banorë me rreth 4.158 familje dhe me një dendësi popullsie 203.91 banorë / km$^2$ dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Qyteti i Shtimes, qendra administrative e komunës  ka klimë kontinentale me rreshje mesatare 673 mm në vit dhe temperatura mesatare -1.4 ºC në Janar dhe 20.6 º C në Korrik.

Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit.

Komuna Shtime ka një sipërfaqe prej 134 km$^2$ (13.450,8 ha) dhe shtrihet  në pjesën qëndrore të Kosovës, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suarekës). Qendra administrative, qyteti i Shtimes është 31 km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45 km larg Prizrenit dhe 13 km nga Ferizaj.



Qyteti i Shtimes gjendet 31 km larg aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, 259 km larg portit të Durrësit 220 km larg portit të Shëngjinit si dhe pozicionohet mes akseve të rëndësishme rrugore Prizren - Prishtinë dhe Prizren - Ferizaj - Shkup.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Qytete | 1 | Tokë bujqësore | 48,4 % |
| Fshatra | 22 | Pyje | 47,4 % |
| Sipërfaqja | 134 $km^2$ | Rrugë urbane | 15.54 km |
| Popullsia | 27,324 banorë | Rrugë komunale | 107.22 km |
| Nr. Familjeve | 4,158 | Dendësia për banorë/$km^2$ | 203.91 |
| Popullsi urbane | 7,255 | Meshkuj | 50,69% |
| Popullsi rurale | 20,069 | Femra | 49,31% |

Komuna Shtime ka nën administrimin e saj qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, 13 prej të cilave shtrihen në zonën kodrinore - malore dhe 9 në zonën fushore.



Komuna e Shtimes njihet si njësi territoriale-administrative që nga fillimi i shekullit XX, më saktësisht që prej Luftës së Parë Botërore. Komuna e humbet më 1932 statusin e saj për shkak të politikës shoviniste serbe të udhëhequr nga Mbretëria e atëhershme jugosllave. Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Shtimja ka funksionuar sërish si komunë, për ta humbur statusin përsëri në vitin 1959. Me 9 qershor të vitit 1988 është rithemeluar Komuna e Shtimes dhe sot është qendër komunale administrative e 22 fshatrave.

## ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL

### Potencialet natyrore

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub rezerva të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë në këtë mënyrë një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

Territori i komunës së Shtimes është i pasur me lumenj. Lumi i Carralevës është një ndër bukuritë natyrore të zonës, në hyrje të Shtimes bashkohet me lumin i cili buron nga malet e Topillës, për t'u bashkuar më pas në qytetin e Shtimes me lumin Shtimjanja dhe duke vazhduar nëpër fshatra me lumin Sitnica. Pellgu i lumit Shtimjanja ka një sipërfaqe prej 14 $km^2$ dhe një gjatësi afër 15 km. Përveç këtij lumi ekzistojnë edhe burime të tjera si ai në Qarrishtë, Reçak etj. Rezervat ujore janë një resurs mjaft i mirë për zhvillimin e bujqësisë, si burim energjitik, por dhe si mundësi turizmi.

Toka bujqësore përbën rreth 48,4 % të territorit të komunës dhe bujqësia ështe dhe mbetet një nga prioritetet zhvillimore të saj. Komuna ka rreth 6,697 ha tokë bujqësore, prej të cilave 4.947 ha janë pjellore. Kullotat zenë një sipërfaqe rreth 1750 ha, ndërsa pyjet 6377,8 ha ose rreth 47.4 % të territorit të Komunës, nga të cilat 45.9% (2926.8 ha) janë publike dhe 54.1% (3451 ha) në pronësi private duke përbërë një aks shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

### Infrastruktura

Infrastruktura e komunës Shtime është zhvilluar në përputhje me planet urbanistike dhe strategjitë e zhvillimit, për rrjedhojë në një periudhë rreth 13 vjeçare janë investuar 34.712.467 Euro në 401 projekte, të cilat janë destinuar për shtrimin e rrugëve (122.76 km); ndërtimin e ujësjellësve (104.1 km), kanalet e ujrave të zeza (52.15 km) si dhe shtrim trotuaresh, sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim publik. Fshatrat e Komunës janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Shtimes, duke krijuar në këtë mënyrë një avantazh për zhvillimet e mëtejshme ekonomike dhe sociale të zonës.

## Zhvillimi i biznesit

Në komunë zhvillojnë aktivitetin 720 biznese (nga 1280 të rregjistruara), nga të cilat 98.89% janë mikrondërmarrje dhe 1.11% janë ndërmarrje të vogla. Struktura sektoriale e të cilave është si në tabele:

| Nr. | Aktivitetet | Bizneset e regjistruara | % |
|---|---|---|---|
| 1 | Prodhuese | 62 | 8.61 |
| 2 | Ndërtimtaria | 45 | 6.25 |
| 3 | Tregtia | 262 | 36.39 |
| 4 | Transporti | 10 | 1.39 |
| 5 | Hoteleria | 42 | 5.83 |
| 6 | Financat | 4 | 0.56 |
| 7 | Shërbimet | 168 | 23.33 |
| 8 | Zejtare | 54 | 7.50 |
| 9 | Tjera | 73 | 10.14 |
| | Gjithsej | 720 | 100 |

Në komunë zhvillojnë aktivitetin e tyre degët e Bankës Private të Biznesit - Shtime, Raiffeissen Bank dhe Pro Credit Bank. Që nga viti 2012 funksion zyra "One Stop Shop" për rregjistrimin e bizneseve e cila ka dhe një funksion tjetër, atë të këshillimit dhe informimit të bizneseve.

## Zonat Ekonomike

Zona Ekonomike është krijuar në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, ajo përfshin një sipërfaqe prej 10.7 ha, ndodhet në km e dytë të rrugës nacionale Shtime – Ferizaj dhe parashikimet janë për rreth 13 biznese dhe 350 të punësuar. Zona synon të mbështesë investitorët vendas dhe të huaj, duke u dhënë tokën në shfrytëzim, duke ngritur një pjesë të infrastrukturës si dhe duke i ofruar një numër lehtësish fiskale

Aktualisht janë duke zhvilluar aktivitetin dy agrobiznese eksportuese, ndërkohë projekti i dytë që po merr jetë është Qendra e Agrobiznesit e cila do të merret me grumbullimin dhe ruajtjen e frutave dhe perimeve nga Shtimja, Lipjani, Ferizaj dhe Drenasi. Ky projekt me një vlerë prej

475.409 Euro është financim i Bashkimit Europian Unionit Evropian në masën 73 % dhe 27 % prej Komunës.




## Bujqësia dhe blegtoria

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi, veçanërisht kultivimin e grurit, misrit dhe disa kulturave të pemëve frutore, rrjedhojë kjo e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore dhe pjellorisë së lartë të saj, por dhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron.

Vitet e fundit, bujqësia ka marrë një zhvillim të ri për shkak të kultivimit në mënyrë intensive të kulturave bujqësore, por dhe rritjes së vetëdijes së fermerëve që bujqësia është prioritet zhvillimor në komunën Shtime.

Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit janë ngritur rreth 30 ha pemishte me mollë dhe kumbull (të kultivuara në mënyrë intensive); mbi 2 ha sera për kultivimin e perimeve dhe luleve; rreth 20 ha me perime në sipërfaqe të hapura dhe rreth 30 ha me lakër.

Impakt në zhvillimin e bujqësisë komunale kanë dhënë dhe projektet e subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si më poshtë: 42.000 euro për ngritjen e 7 ha pemishte të reja në tre ferma; 6.000 euro për rregullimin e infrastrukturës në një pemishte; 20.000 euro për ngritjen e një pularie me kapacitet 3600 pula. Gjithashtu, janë bërë dhe subvencionimet e mëposhtme: për kulturën e grurit 209 persona me një vlerë 93.019 Euro; për lopët qumështore 47 persona me një vlerë 16.850 Euro; për dele 16 persona me një vlerë 13.190 Euro, për kulturën e misrit 42 persona me një vlerë 10.355 Euro dhe disa subvencione të tjera për

rritjen e bletëve, dhive dhe kultivimin e lulediellit rreth 7.000 Euro (të dhënat i referohen vitit 2012, 2013 është në vazhdim)

Ky zhvillim është reflektuar në krijimin e disa shoqatave si: Shoqata e Blegtorëve BioCop, EuroCoop 2005, Shoqata e Perime-kulturës Horticoop, Shoqata e Bletarëve "Nektari i Bletës" etj., të cilat kërkojnë mbështetjen e duhur për mirëfunksionimin dhe rritjen e efikasitetit të tyre në tregun rajonal e më gjerë.

## Arsimi

Procesin edukativo-arsimor, nga ai parashkollor deri në shkollimin e mesëm të lartë, e ndjekin 7323 nxënës, të cilët kanë në dispozicion një institucion parashkollor, shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 13 paralele të ndara, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i detyrueshëm dhe përqindja e ndjekjes së shkollimit është 99.72 %, ndërsa arsimi i mesëm i lartë ende nuk është i detyrueshëm por vijueshmëria në përqindje është 94.51 %.

| **Institucionet arsimore** | **Meshkuj** | **Femra** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|
| Arsimi parashkollor 9 muaj – 5 vjeç (çerdhe) | 13 | 9 | 22 |
| Arsimi parafillor 0-5 vjeç | 199 | 180 | 379 |
| Arsimi fillor (1 – 5) | 1354 | 1301 | 2655 |
| Arsimi i mesëm i ulët (6 – 9) | 1345 | 1217 | 2562 |
| Gjimnazi (10 – 12) | 336 | 464 | 800 |
| Drejtimet Profesionale (10 – 13) | 630 | 275 | 905 |
| | 3877 | 3446 | 7323 |

Politikat arsimore janë qendrore dhe komuna luan rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ofrimin e bashkëpunimit që synon rritjen e kapaciteteve dhe prioritetet e zhvillimit komunal.

## Kultura dhe Sporti

Në komunën e Shtimes zhvillojnë aktivitetin e tyre kulturor dhe artistik disa shoqëri, ku spikat Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Dita" nga qyteti i Shtimes. Biblioteka e Qytetit me fondin e

saj të librave që pasurohet çdo ditë, i jep qytetit një dimension të ri kulturor. Gjithashtu, me qellim ruajtjen e relikteve historike dhe njohjen e së kaluarës historike të trevës së Shtimes, e cila ishte mjaft e bujshme, me plot sakrifica e luftra për liri, më 19. 1. 2004 është themeluar Muzeu i Qytetit, për të cilin kujdeset Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Historia e komunës së Shtimes lidhet me disa objekte përkujtimore si: Varrezat e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Shtime dhe Mollopolc, Kompleksi Memorial "Masakra e Reçakut" si dhe një numër objektesh të kultit si kisha, xhami dhe tyrbe.

Qendra Rinore në Shtime synonë masivizimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe social të të rinjve. Sporti në Komunë do të marrë një dimension të ri me përfundimin e palestrës sportive dhe stadiumit të futbollit.

### Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor në Komunë është i organizuar në dy nivele: Kujdesi Primar përmes Shtëpisë së Shëndetit apo Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Kujdesi Sekondar - niveli specialistik në (QKMF) si dhe përmes poliklinikave specialistike të organizuara në sektorin privat.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), funksionon me Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), në fshatrat Pjetërshticë, Muzeqinë, Petrovë si dhe përgatitja e objekteve të (QMF) - ve në Godanc dhe Carralevë përmbledh: shërbimin primar shëndetësor të mjekësisë së përgjithshme, duke përfshirë edhe mjekësinë urgjente; shërbimin internistik; shërbimin pediatrik; shërbimin gjinekologjik; shërbimin stomatologjik primar, shërbimin e preventivës (vaksinimit); shërbimin e diagnostikimit (laboratori dhe radiologjia).

QKMF-ja ka një personel prej 15 mjekësh prej të cilëve 4 specialistë, 2 stomatologë, 45 teknikë mjekësorë dhe pjesa tjetër personel ndihmës mjekësor. Në sektorin privat funksionojnë tetë poliklinika specialistike nga të cilat: dy kirurgji, dy gjinekologji, dy pediatri, një praktikë e përgjithshme dhe gjashtë stomatologji.

## Përmbajta

........................................................................................................................1

Përmbajta........................................................................................................................8

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE....................10
Aftësitë....................10
Shanset....................10
Dobësitë....................10
Rreziqet....................10
Vizioni....................11
Qellimet dhe Objektivat....................12
Qellimi 1 - Te krijohet nje klime e favorshme per zhvillimin e biznesit ....................12
Qellimi 2- Te permiresohet cilesia e sherbimeve publike dhe ifrastruktures ....................12
Qellimi 4- Te promovohet zhvillimi i bujqesise intensive ....................13
QELLIMI 5- Te krijohet nje mjedis i favorshem socio-kulturor, arsimor dhe ekologjik ....................13
QELLIMI 6- Te promovohet shfrytezimi i burimeve natyrore ....................14
AKTIVITETET (A) DHE PROJEKTET SPECIFIKE (P)....................14

# ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

<table>
<tr>
<td>

**Aftësitë**

1) Infrastruktura
2) Pozita gjeografike (strategjike)
3) Burimet njerëzore (mosha e re,kualifikimi)
4) Resurset natyrore (toka, pyjet)
5) Kompleksi përkujtimor i Reçakut
6) Tradita e punës në përpunimin e drurit dhe agrobiznesit
7) Ekspertët në sektorin e bujqësisë
8) Remitancat(të ardhurat sezonale)
9) Teknologjia (Interneti)
10) Klima
11) Resurset natyrore (ujore, minerale, shpellat, gjurmimet arkeologjike)
12) Zejtaria (perpunimi i llamarinës)
13) Ekzistenca e planeve zhvillimore afatgjatë
14) Qetësia publike (niveli i ulët i kriminalitetit)
15) LNK

</td>
<td>

**Shanset**

1) Proçesi i privatizimit në funksion të zhvillimit ekonomik
2) Fondet strukturore të BE-së.
3) Subvencionimi
4) Infrastruktura rrugore
5) Partneriteti P-P
6) Nxitja dhe mbështetja e SME-ve
7) Përmirësimi i kushteve për kredi (ulja e kamatave)
8) Liberalizimi i arsimit, shëndetësisë
9) CEFTE (hapja e tregut rajonal)
10) MSA
11) Liberalizimi i vizave
12) Përdorimi i Euros
13) Trendi i rritjes ekonomike në Kosovë
14) Qasja në institucionet financiare ndërkombëtare
15) IHD ( Investimet e huaja)
16) Lehtësira për hapjen e një biznesi
17) Raportet pozitive ndëretnike

</td>
</tr>
<tr>
<td>

**Dobësitë**

1) Niveli i lartë i papunësisë
2) Mungesa e kabineteve laboratorike në shkolla
3) Ekonomia informale
4) Niveli i ulët i inkasimit të të hyrave vetanake
5) Menaxhimi i dobët i territorit (ndërtimet pa leje)
6) Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje
7) Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e infrastruktures
8) Mungesa e menaxhimit të mbetjeve urbane
9) Ndotja e mjedisit (nga gurëthyesit)
10) Mungesa e hapësirave të gjelbërta në zonat urbane

</td>
<td>

**Rreziqet**

1) Nieveli i larte i informalitetit
2) Mungesa e politikave atraktive për tërheqjen e investitorëve
3) Perceptimi mbi sigurinë
4) Mungesa e ekonomisë konkuruese
5) Largimi i "trurit" (moshës së re)
6) Mungesa e sigurimeve shëndetësore
7) Mungesa e strategjisë së arsimit
8) Mungesa e strategjisë nacionale për zhvillim ekonomik

</td>
</tr>
</table>

# VIZIONI

Komunë që krijon mundësinë potenciale për zhvillimin e infrastrukturës, biznesit, agrobiznesit dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore duke ruajtur ambientin dhe trashëgiminë.

# QELLIMET DHE OBJEKTIVAT

## QELLIMI 1 - TE KRIJOHET NJE KLIME E FAVORSHME PER ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Q1 - OBJEKTIVI 1 - Krijimi i katër zonave të biznesit me kapacitet prej 70 bizneseve deri në vitin 2018

Q1 - OBJEKTIVI 2 - Zvogëlimi i informalitetit në masën 50% deri në vitin 2018

Q1 - OBJEKTIVI 3 - Trajnimi/keshillimi i 50 sipërmarrësve në fushën e hartimit të planeve të biznesit dhe planeve investive deri në vitin 2015

Q1 - OBJEKTIVI 4 - Hartimi i guidave për promovimin e biznesit deri në vitin 2014

## QELLIMI 2- TE PERMIRESOHET CILESIA E SHERBIMEVE PUBLIKE DHE IFRASTRUKTURES

Q2 - OBJEKTIVI 1 - Dixhitalizimi i të gjitha sherbimeve publike brenda periudhës kohore 2014-2018

Q2 - OBJEKTIVI 2 - Kompletimi i infrastrukturës shkollore (ndërtimi i objekteve, pajisjeve, laboratoreve dhe mjeteve të tjera përcjellëse) deri në vitin 2018

Q2 - OBJEKTIVI 3 - Krijimi i 30 ha hapësirë të gjelber në qytet dhe fshatra deri në vitin 2018

Q2 - O4 - Funksionalizimi i mjeksisë familjare në të gjithë territorin e komunës së Shtimes deri në vitin 2017

Q2 - OBJEKTIVI 5 - Ngritja e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore që ofrojnë sherbimet publike përmes trajnimeve, vizitave studimore dhe edukimit formal

Q2 - OBJEKTIVI 6 - Funksionalizimi i Sistemit të menaxhimit të cilësisë në të gjitha institucionet publike të komunës së Shtimes deri në vitin 2018

Q2 - OBJEKTIVI 7 - Kompletimi i planeve rregulluese dhe infrastrukturës fizike (rrugë, trotuare, kanalizime, ndriçim publik, shenjëzimi, tregjeve, stacionet e autobuzave, ndërtesat komunale, lumenj)

## QELLIMI 3 - TE ZHVILLOHET TURIZMI RURAL

Q3 - OBJEKTIVI 1 - Shpallja dhe promovimi i 3 zonave turistike rurale: a-Llanisht - Topille - Devetak, b - Caraleve-Rance, c - Karacice - Duge -Pjetershtice, deri në vitin 2014

Q3 - OBJEKTIVI 2 - Hartimi i planit rregullues dhe rregullimi i infrastrukturës bazë në 3 zonat turistike deri në 2015

Q3 - OBJEKTIVI 3 - Këshillimi dhe trajnimi i banorëve të zonave për zhvillimin e turizmit rural deri në 2016

## QELLIMI 4- TE PROMOVOHET ZHVILLIMI I BUJQESISE INTENSIVE

Q4 - OBJEKTIVI 1 - Zgjerimi i sipërfaqeve nën ujitje nga 100 në 400 ha, deri ne vitin 2018

Q4 - OBJEKTIVI 2 - Subvencionimi i 20 fermerëve në vlerë prej 150000 euro për ndërtimin ose zgjerimin e serave deri në vitin 2018

Q4 - OBJEKTIVI 3 - Subvencionimi i 30 fermerëve (pemtari, blegtori) në një vlerë prej 250000 euro deri në vitin 2018

Q4 - OBJEKTIVI 4 - Këshillimi dhe trajnimi i 100 fermerëve për zhvillimin e bujqësisë intensive deri në vitin 2016

Q4 - OBJEKTIVI 5 - Mbështetja dhe subvencionimi me një vlerë 100000 euro i ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe distribuimit të produkteve bujqësore deri në vitin 2016

## QELLIMI 5- TE KRIJOHET NJE MJEDIS I FAVORSHEM SOCIO-KULTUROR, ARSIMOR DHE EKOLOGJIK

Q5 - OBJEKTIVI 1 - Mbështetja dhe promovimi i 10 talenteve në vit për arritje të veçanta në arsim, kulturë dhe sport në vlerën 10000 euro

Q5 - OBJEKTIVI 2 - Organizimi i festës "Dita e Luleve" si festë tradicionale vjetore e komunës

Q5 - OBJEKTIVI 3 - Mbështetja e njerëzve në nevojë, në vlerën prej 200000 euro deri në vitin 2018

Q5 - OBJEKTIVI 4 - Mbështetja çdo vit e 10 aktiviteteve te veçanta rinore, sportive dhe kulturore në vlerën 60000 euro

Q5 - OBJEKTIVI 5 - Sensibilizimi i përvitshëm i publikut dhe komunitetit të biznesit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit në vlerën 50000 euro

Q5 - OBJEKTIVI 6 - Mbështetja e bizneseve që prodhojnë energji alternative

## QELLIMI 6- TE PROMOVOHET SHFRYTEZIMI I BURIMEVE NATYRORE

Q6 - OBJEKTIVI 1 - Analiza e kapaciteteve aktuale të burimeve natyrore të komunës

Q6 - OBJEKTIVI 2 - Përcaktimi i zonave për shfrytëzim të gurit dhe mineraleve si dhe caktimi i kushteve për shfrytëzimin e tyre

Q6 - OBJEKTIVI 3 - Përcaktimi i zonave për prodhimin e energjisë, ujit të pishëm dhe kultivimin e peshkut

Q6 - OBJEKTIVI 4 - Eksplorimi, konservimi, promovimi dhe funksionalizimi i bukurive natyrore dhe gjurmëve të trashegimisë historike

Q6 - OBJEKTIVI 5 - Promovimi dhe shfrytëzimi i 2 zonave pyjore për gjueti dhe krijimi i 1 rezervati per kultivimin dhe rritjen e kafshëve të egra deri në vitin 2018

## AKTIVITETET (A) DHE PROJEKTET SPECIFIKE (P)

| | Qellimet | Objektivat | Aktivitet | Projektet | Koha e Realizimit | Kostoja ne EURO |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Qellimi 1** Të krijohet një klimë e favorshme | **O1 -** Krijimi i katër zonave të biznesit me kapacitet prej 70 bizneseve | **A1:** Shpallja (rikonfirmimi) dhe legalizimi i zonave me interes të veçantë | **A1-P1:** Perkufizimi i zonave të biznesit<br>**A2-P1:** Hartimi i Planeve Rregulluese për: zonën Ekonomike, Rruga e Ferizajit, | 2014<br><br>2015 | ?<br><br>? |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për zhvillimin e biznesit | deri në vitin 2018 | **A2:** Hartimi i planeve rregulluese për katër zonat e bizneseve<br><br>**A3:** Promovimi i zonave të biznesit<br><br>**A4:** Funksionalizimi i zonave të biznesit | Lipjanit dhe Prizrenit 2015<br><br>**A3-P1:** Fushata për Promovimin e zonave të biznesit<br><br>**A4-P1:** Rregullimi i Infrastrukturës në Zonën Ekonomike Shtime<br><br>**A4-P2.** Rregullimi i Infrastrukturës në tri zonat e biznesit (në Rrugën e Ferizajit, Lipjanit dhe Prizrenit)<br><br>**A4-P3**. Shpallja e Ankandit për shfrytëzimin & funksionalizimin e parcelave brenda Zonës Ekonomike Shtime 2014 - 2018 | 2015<br><br>2014 - 2018<br><br>(2015 – 2018)<br><br>2014 - 2018 | ?<br><br>290.000 EUR<br><br>100.000 EUR<br><br>? |
| | | **O2 -** Zvogëlimi i informalitetit në masen 50% deri në vitin 2018 | **A1:** Identifikimi i bizneseve jo formale<br><br>**A2:** Vetëdijsimi i bizneseve për formalitet<br><br>**A3:** Zbatimi i akteve dhe nen akteve ligjore | **A1-P1:** Identifikimi i bizneseve jo formale<br>**A2-P1:** Fushata për vetëdijsimin e bizneseve dhe opinionit per formalitet<br>**A3-P1:** Formimi i task forcës për luftimin e informalitetit<br>**A3-P2:** Prioterizimi i ndëshkimeve të veprimtarive me informalitet/rrezikshmëri të lartë | 2014<br><br>2015<br><br>2015<br><br>2015 | 10000 EUR |
| | | **O3 -** Trajnimi/këshillimi i 50 sipërmarrësve në fushën e hartimit të planeve të biznesit dhe planeve investive deri në vitin 2015 | **A1:** Përcaktimi i kritereve dhe përzgjedhja e sipërmarrësve/fushave të biznesit<br><br>**A2:** Përzgjedhja e metodologjisë për trajnim/këshillim të bizneseve | **A1 – P1:** Përzgjedhja e sipërmarrësve përfitues të projektit për këshillime dhe trajnime<br><br>**A2 – P1:** Shpallja e tenderit për zbatimin e këshillimeve/trajnimeve | 2015<br><br>2015 | 18.000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **O4 -** Hartimi i guidave për promovimin e biznesit deri në vitin 2014 | **A1:** Identifikimi dhe prezantimi i vlerave, resurseve dhe potencialeve për tërheqjen e investimeve<br><br>**A2:** Përcaktimi i metodologjisë së prezantimit të guidave/udhëzuesve<br>**A3:** Plasimi i guidave/udhëzuesve për grupet e caktuara të interesit | **A1-P1:** Përzgjedhja e zbatuesit të projektit për identifikimim e vlerave dhe resurseve për tërheqjen e investimeve<br>**A2-P1:** Promovimi i guidave/udhëzuesve për tërheqjen e investimeve | 2014<br><br>2014 | 5000 EUR<br><br>5000 EUR |
| | **Qellimi 2**<br>Të përmirësohet cilësia e sherbimeve publike dhe ifrastrukturës | **O1-** Dixhitalizimi i të gjitha sherbimeve publike brenda periudhës kohore 2014-2018<br><br>**O2-** Kompletimi i infrastrukturës shkollore (ndërtimi i objekteve, pajisjeve, laboratoreve dhe mjeteve të tjera përcjellëse) deri në vitin | **A1:** Hartimi i manualit për dixhitalizimin e sherbimeve publike<br><br>**A2:** Zhvillimi i sherbimeve përmes SMS & E kioskave<br><br>**A3:** Dixhitalizimi i QMF dhe shkollave nëpër fshatra dhe lidhja me qendren<br>A4: Dixhitalizimi i bashkësive lokale<br><br>**A1:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e shkollave<br>**A2**: Furnizimi i shkollave dhe funksionalizimi i tyre me laboratore dhe mjete tjera përcjellëse<br>**A3**: Ngritja e kapaciteteve njerëzore | **A1-P1:** Hartimi dhe publikimi i manualit për dixhitalizim të sherbimeve<br><br>**A2 – P2:** Blerja e paisjeve dhe Funksionalizimi i sherbimeve përmes SMS dhe E Kioskave<br><br>**A3 – P1:** Blerja e paisjeve dhe dixhitalizimi i QKMF dhe QMF-ve<br><br>**A3 – P2:** Blerja e paisjeve dhe dixhitalizimi i shkollave të nivelit të edukimit primar<br><br>**A4 – P1:** Blerja e paisjeve dhe dixhitalizimi i njesive administrative lokale<br><br>**A1-P1:** Ndërtimi i Shkollës në Pjetershticë<br><br>**A1-P2:** Ndërtimi i shkollës në Muzeqine<br><br>**A1-P3:** Ndërtimi i Shkollës në Carraleve<br><br>**A1-P4:** Ndërtimi i aneksit të shkollës në Rashince | 2014-2018<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018<br><br>2014–2015<br><br>2014-2015<br><br>2015-2016<br><br>2016 – 2017<br><br>2014 | 3000 EUR<br><br>10.000 EUR<br><br>10.000 EUR<br>20 000 EUR<br><br>20.000 EUR<br><br>1000.000 EUR<br><br>700.000EUR<br><br>850.000 EUR<br><br>700.000 EUR<br><br>150.000 EUR<br><br>50.000 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2018 | profesionale dhe menaxhuese | **A1-P5:** Ndërtimi i aneksit të shkollës në Gjurkovce<br><br>**A1-P6:** Ndërtimi i shkollës në Vojnovc<br><br>**A1-P7:** Rinovimi dhe furnizimi i shkollave me paisje<br><br>**A2- P1:**Furnizimi i 8 shkollave me Laboratore me 2014 – 2016 ne vlere 120000<br><br>**A2-P2:** Furnizimi i 8 shkollave me paisje sportive<br><br>**A2-P3:** Furnizimi i 8 shkollave me paisje muzikore<br><br>**A2-P2:** Furnizimi i 8 biblotekave shkollave me lektyra shkollore<br><br>**A3 - P1:** Trajnimi/zhvillimi profesional dhe menaxhues i personelit Administrativ/mësimdhenes | 2014<br><br>2017-2018<br><br>2014 - 2018<br><br>2014-2016<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015<br><br>2016-2018<br><br>2014-2018 | EUR<br><br>450.000 EUR<br><br>50.000 EUR per cdo vit<br><br>120.000 EUR<br><br>50.000 EUR<br><br>40.000 EUR<br><br>20.000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | | **O3-**Krijimi i 30 ha hapësirë të gjelbër në qytet dhe fshatra deri në vitin 2018 | **A1:** Përcaktimi i hapsirave të gjelbërta në qytet dhe fshatra<br>A2: Ngritja dhe konsolidimi i hapsirave të gjelbërta<br><br>**A3:** Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse në hapësirat e gjelbërta | **A1 – P1:** Përkufizimi i hapësirave të gjelbërta/përbashkëta në qytet dhe nëper fshatra<br><br>**A2 – P1:** Ngritja dhe konsolidimi i i hapësirave të gjelbërta publike nga 20000 euro në vit<br><br>**A3 – P1:** Rregullimi i parkut të qytetit "te Pishat" | 2014<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018 | 5000 EUR<br><br>20.000 EUR në vit<br><br>400.000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **A4:** Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta | **A4 – P1:** Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike | 2014-2018<br>2014 | 200.000 EUR<br>50000 EUR |
| | | **O4-** Funksionalizimi i mjeksisë familjare në të gjithë territorin e komunës së Shtimes deri në vitin 2017 | **A1:** Ndërtimi dhe funksionalizimi i objekteve të MF<br><br>**A2:** Paisja e QMF-ve me teknologji moderne<br><br>**A3:** Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe menaxhuese të QMF<br><br>**A4:** Modernizimi i qendrës emergjente | **A1-P1:** Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-së në Godanc<br><br>**A1-P2:** Funksionalizimi i QMF në Carraleve<br><br>**A1-P3:** Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF në Shtime<br><br>**A2 – P1:** Paisja e QMF-ve me teknologji moderne në vlerë 10 000 në vitin 2014<br><br>**A3 – P1:** Trajnimi profesional dhe menaxhues për stafin e QKMF-se dhe QMF-ve në vitin 2014 në vlerë 10000 EUR<br><br>**A4 – P1:** Furnizimi i Qendres Emergjente me makinë emergjente, aparaturë dhe paisje medicionale 40000 | 2014<br><br>2015-2018<br><br>2014<br><br>2014<br><br>2014 | 10000 EUR<br><br>300.000 EUR<br><br>10000 EUR<br><br>10000 EUR<br><br>40000 EUR |
| | | **O5-**Ngritja e kapaciteteve profesionale te burimeve njerëzore që ofrojnë sherbimet publike përmes trajnimeve, vizitave | **A1:** Analiza e gjendjes ekzistuese dhe nevojave për zhvillim profesional/trajnim<br><br>**A2:** Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe menaxhuese të resurseve njerëzore | **A1 – P1**: Analiza e gjendjes ekzistuese te burimeve njerezore dhe nevojave per trajnime<br><br>**A2 – P2** Përzgjedhja e zbatuesit të projektit për trajnim dhe ngritje të kapaciteteve të resurseve njerëzore | 2014 | 10000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | studimore dhe edukimit formal | | | | |
| | | **O6-** Funksionalizimi i Sistemit të menaxhimit të cilësisë në të gjitha institucionet publike të komunës së Shtimes deri në vitin 2018 | **A1:** Analiza e gjendjes ekzistuese të Sistemit MC<br><br>**A2:** Ngritja dhe funksionalizimi i SMC<br><br>A4: Mirëmbajtja e SMC | **A1 – P1:** Ngritja dhe Funksionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC-se) sipas Standardeve Ndërkombetare ISO 9001: 2008 deri 2014 në vlerë 10 000 EUR<br>**A3 – P1:** Certifikimi Ndërkombetar i SMC sipas Standardeve Ndërkombetare ISO 9001<br><br>**A4 – P1:** Mirëmbajtja e SMC-së | 2014<br><br>2014<br><br>2014 - 2018<br><br>2014- 2018 | <br><br>10000 EUR<br><br>5000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | | **O7-** Kompletimi i planeve rregulluese dhe infrastrukturës fizike (rrugë, trotuare, kanalizime, ndriçim publik, shenjezimi, tregjeve, stacionet e autobusave, ndërtesat komunale, lumenj) | **A1:** Hartimi i Planeve rregulluese urbane (nëpër fshatra)<br><br>**A2:** Asfaltimi dhe mirembajtja e rrugeve, urave dhe trotuareve<br><br>**A3:** Ndertimi dhe mirembajtja e kanalizimeve, ndriçimit publik dhe shenjëzimit<br><br>**A4:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve dhe stacioneve të autobuseve,<br><br>**A5:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave komunale<br><br>**A6:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e | **- P1:** Hartimi i planeve rregulluese urbane<br><br>**A1 – P2:** Hartimi i Planeve rregulluese rurale<br><br>**A1 – P1:** Asfaltimi i rrugëve në brendësi të fshatit Godance i ulët – Godance i Epërm<br><br>**A1 – P2:** Ndërtimi i rrugëve në brendësi të fshatit Muzeqinë<br><br>**A1 – P3:** Ndërtimi i rrugeve ne brendi te fshatit Carraleve<br><br>**A1 – P4:** Ndërtimi dhe rregullimi i rrugeve ne qytetin e Shtimes<br><br>**A1 – P5:** Ndërtimi i unazës së brendshme<br><br>**A1 – P6:** Ndërtimi i rrugëve në brendësi të fshatit Gjurkovc | 2014- 2018<br><br>2014- 2015<br><br>2014- 2015<br><br>2014- 2015<br><br>2014- 2018<br><br>2016- 2018<br><br>2015- 2016<br><br>2015- 2016 | 150.000 EUR<br><br>50.000 EUR<br><br>100.000 EUR<br><br>70.000 EUR<br><br>110000 EUR<br><br>250.000 EUR<br><br>1.200.000 EUR<br><br>50.000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shtretërve të lumenjëve | **A1 – P7:** Ndertimi i rrugëve në brendësi të fshatit Pjetershtice<br><br>**A1 – P8:** Ndërtimi i rrugëve në brendësi të fshatit Rashince & Zborc<br><br>**A1 – P9:** Ndërtimi i rrugëve në brendësi të fshatit “Lagja e Pajtimit”<br><br>**A1 – P10:** Ndërtimi i Rrugës Godanc i eperm – Kraishte<br><br>**A1 – P11:** Ndërtimi Rrugës Godanc i ulet – Gjergjaj<br><br>**A1 – P12:** Ndërtimi i rrugës Zborc – Pjetershtice<br><br>**A1 – P13:** Ndërtimi i rrugës Topille<br><br>**A1 – P14:** Rregullimi i rrugëve me zhavor për toka bujqësore<br><br>**A1 – P15:** Ndërtimi i urës në Petrove<br><br>**A1 – P16:** Ndërtimi i urës në Carraleve<br><br>**A1 – P17:** Ndërtimi i urës në Shtime në “Bashkësinë e Dytë”<br><br>**A1 – P18:** Rregullimi i trotuareve Shtime – Davidovc 2014 – 2015 në vlerë 50000<br><br>**A1 – P19:** Rregullimi i trotuarit Shtime – zona Ekonomike | 2014 - 2016<br><br>2015-2017<br><br>2014<br><br>2015-2016<br><br>2016-2017<br><br>2016<br><br>2014-2018<br><br>2014<br><br>2014-2015<br><br>2015-2016<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015 | 60.000 EUR<br><br>80.000 EUR<br><br>80.000 EUR<br><br>500.000 EUR<br><br>250000 EUR<br><br>450.000 EUR<br><br>250.000 EUR<br><br>250000 euro per cdo vit<br><br>100.000 EUR<br><br>25.000 EUR<br><br>50.000 EUR<br><br>50000 EUR<br><br>30.000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **A1 – P20:** Rregullimi i trotuarit Shtime – Godance<br><br>**A1 – P21:** Vazhdimi i trotuareve Carraleve<br><br>**A1 – P22:** Rregullimi i trotuareve Muzeqine<br><br>**A1 – P23:** Rregullimi i trotuareve në Petrove<br><br>**A1 – P24:** Rregullimi i Trotuareve në Shtime<br><br>**A2 – P1:** Ndërtimi i kanalizimit në Mollopolc dhe Petrove<br><br>**A2 – P2:** Ndërtimi i kanalizimit në Vojnovc 2014 – 2015 në vlerë 50000 EUR<br><br>**A2 – P3:** Ndërtimi i kanalizimit në Godance<br><br>**A2 – P4:** Ndërtimi i kanalizimit në Pjetershticë<br><br>**A2 – P5:** Ndërtimi i kanalizimit në Carraleve<br><br>**A2 – P6:** Ndërtimi i kanalizimit në Gjergjaj<br><br>**A2 – P7:** Ndërtimi i kanalizimit në lagjen e Pajtimit<br><br>**A2 – P8:** Ndërtimi i kanalizimit ne Gllavice<br><br>**A2 – P9:** Ndërtimi i kanalizimit në Zborce<br><br>**A2 – P10:** Ndriçimi Publik në qytetin e Shtimes | 2014-2016<br><br>2015-2016<br><br>2015-2017<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015<br><br>2014-2015<br><br>2014-2016<br><br>2014-2016<br><br>2014-2016<br><br>2014-2016<br><br>2014-2015<br><br>2014-2016<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018 | 70000 EUR<br><br>40000 EUR<br><br>30000 EUR<br><br>40000 EUR<br><br>50000 EUR<br><br>85000 EUR<br><br>50.000 EUR<br><br>90.000 EUR<br><br>50.000 EUR<br><br>150.000 EUR<br><br>55000 EUR<br><br>65000 EUR<br><br>30.000 EUR<br><br>70000 EUR<br><br>20000 EUR ne vit<br><br>10000 EUR ne |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **A2 – P11:** Ndriçimi Publik në Fshatra<br><br>**A2 – P12:** Shenjëzimi i rrugëve urbane dhe lokale në komunë<br><br>**A2 – P13:** Ndërtimi i tre rezervareve të ujit<br><br>**A2 – P14:** Ndërtimi i impianteve të ujrave të zeza<br><br>A3 – P1: Ndërtimi i tregut të gjelbërt dhe atij të mallrave<br><br>A3 – P2: Ndërtimi i tregut të kafshëve, ushqimit dhe materialeve ndërtimore<br><br>**A3 – P3:** Ndërtimi i Stacionit të Autobusave<br><br>**A3 – P4:** Rregullimi i vend ndaljeve (stacioneve) për autobuse<br><br>**A4 – P1:** Ndërtimi i ndërtesës Komunale<br><br>**A4 – P2:** Ndërtimi i ndërteses së Gjykates Themelore dhe Prokurorisë<br><br>**A4 – P3:** Rinovimi dhe paisja e ndërtesave publike - komunale<br><br>**A4 – P4:** Rinovimi i objektit "Komuna e Vjeter"<br><br>**A4 – P5:** Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës<br><br>**A4 – P6:** Ndërtimi i Kompleksit memorial | 2014-2016<br><br>2014-2018<br><br>2014-2015<br><br>2014-2016<br><br>2015-2016<br><br>2014-2016<br><br>2015<br><br>2015<br><br>2014-2018<br><br>2014-2015<br><br>2014<br><br>2014-2015<br><br>2014-2018<br><br>2014-2018 | vit<br><br>5000 EUR ne vit<br><br>300.000 EUR<br><br>4.000.000 EUR<br><br>60.000 EUR<br><br>120.000 EUR<br><br>1.500.000 EUR<br><br>80.000 EUR<br><br>900.000 EUR<br><br>450.000 EUR<br><br>50000 EUR per vit<br><br>150000 EUR<br><br>750000 EUR<br><br>900.000 EUR<br><br>660000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **A5 – P1:** Zgjerimi, pastrimi i shtratit të lumit dhe kolektorit të ujrave të zeza përgjatë lumit Shtimjanja<br><br>**A4 - P6:** Ndërtimi i një Qendre Kulturore të femijeve | | 200.000 EUR |
| | **Qellimi 3** Te zhvillohet turizmi rural | **O1-** Shpallja dhe promovimi i 3 zonave turistike rurale: a-Llanisht-Topille-Devetak, b-Caraleve-Rance, c-Karacice-Duge-Pjetershtice, deri në vitin 2014<br><br>**O2-** Hartimi i planit rregullues dhe rregullimi i infrastrukturës bazë në 3 zonat turistike deri në 2015<br><br>**O3-** Këshillimi dhe trajnimi i banorëve të zonave për zhvillimin e turizmit rural deri në 2016 | **A1:** Shpallja e zonave me interes të veçante<br><br>**A2:** Promovimi i zonave turistike<br><br>**A3:** Funksionalizimi i zonave turistike<br><br>**A1:** Studimi i Fizibilitetit<br><br>**A2:** Hartimi dhe aprovimi i planeve specifike rregulluese<br><br>**A3:** Shpronsimi i pronave<br><br>**A4:** Rregullimi i Infrastrukturës bazë<br><br>**A1:** Analiza e gjendjes dhe përcaktimi i kritereve dhe metodologjise se keshillimeve/trajnimeve | **A1 – P1:** Hartimi i Projektit të 3 zonave turistike rurale<br><br>**A2 – P1:** Promovimi i tri zonave turistike<br><br>**A3 – P1:** Shpallja e Interesit dhe perzgjedhja e operatoreve për funksionalizimin e zonave turistike<br><br>**A1 – P1:** Studimi i Fizibilitetit për 3 zonat turistike<br><br>**A1 – P2:** Hartimi i Planit rregullues për 3 zonat Turistike<br><br>**A1 – P3:** Shpronsimi i pronave me interes për tri zonat turistike<br><br>**A1 – P4:** Rregullimi i infrastruktures bazë për tri zonat turistike<br><br>**A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit për potencialet dhe nevojat ekzistuese të banorëve të zonave<br><br>**A2 – P1:** Ngritja e kapaciteteve/trajnimi i banoreve te zonave | 2014-2015<br><br>2015<br><br>2015-2016<br><br>2014-2015<br><br>2015<br><br>2015-2017<br><br>2015-2018<br><br>2015<br><br>2015-2016 | 50000 EUR<br><br>10000 EUR<br><br>5000 EUR<br><br>10000 EUR<br><br>60000 EUR<br><br>200.000 EUR<br><br>200.000 EUR<br><br>10.000 EUR<br><br>10.000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **A2:** Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe menaxhuese te banoreve te zonave | | | |
| | **Qellimi 4** Të promovohet zhvillimi i bujqësise intensive | **O1-** Zgjerimi i siperfaqeve nën ujitje nga 100 në 400 ha, deri në vitin 2018 | **A1:** Identifikimi i zonave për zgjerim dhe studimi i fizibilitetit<br><br>**A2:** Hartimi i projekteve<br><br>**A3:** Rregullimi i infrastrukturës për ujitje<br><br>**A4:** Vetedijsimi i banorëve për rëndësinë e zgjerimit të zonave nën ujitje | **A1 – P1:** Studimi i Fizibilitetit për siperfaqet e reja nën ujitje<br><br>**A1 – P2:** Hartimi i projekteve rregulluese 2015 - 2016 në vlerë prej 20000 EUR<br><br>**A1 – P3:** Rregullimi i infrastrukturës së ujitjes (mini digave dhe kanaleve) 2016 – 2017 në vlerë prej 800000 EUR<br><br>**A1 – P4:** Sensibilizimi i banorëve për rëndësinë e ujitjes 2016 në vlerë prej 10000 EUR<br>**A1 - P5:** Rregullimi i kanaleve të ujitjes | 2014-2015<br><br>2015-2016<br><br>2016-2017<br><br>2016 | 20000 EUR<br><br>20000 EUR<br><br>800.000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | | **O2-** Subvencionimi i 20 fermereve në vlere prej 150000 euro per ndertimin ose zgjerimin e serave deri ne vitin 2018 | **A1:** Percaktimi i kritereve, shpallja, sensibilizimi dhe përzgjedhja e përfituesve për subvencionim<br><br>**A2:** Ndarja e subvencioneve | **A1 – P1:** Shpallja dhe përzgjedhja e përfituesve për subvencionim<br><br>**A1 – P2:** Subvencionimi i 20 fermerëve | 2014<br><br>2014-2018 | 10000 EUR<br><br>140.000 EUR |
| | | **O3-** Subvencionimi i 30 fermerëve (pemtari, blegtori) në nje vlere prej 250000 euro deri në 2018 | **4** Përcaktimi i kritereve, shpallja, sensibilizimi dhe përzgjedhja e përfituesve për subvencionim<br><br>**A2:** Ndarja e subvencioneve | **A1 – P1:** Shpallja dhe përzgjedhja e përfituesve për subvencionim<br><br>**A1 – P2:** Subvencionimi i 20 fermerëve | 2014<br><br>2014-2018 | 10000 EUR<br><br>240000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **O4-** Këshillimi dhe trajnimi i 100 fermereve për zhvillimin e bujqësisë intensive deri në vitin 2016 | **A1:** Analiza e gjendjes, percaktimi i kritereve dhe metodologjisë së keshillimeve/trajnimeve<br><br>**A2:** Ngritja e kapaciteteve profesionale për zhvillimin e bujqësisë intensive | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit për potencialet dhe nevojat ekzistuese të fermerëve për zhvillimin e bujqësisë intensive<br><br>**A1 – P2:** Ngritja e kapaciteteve/trajnimi i fermereve për zhvillimin e bujqësisë intensive 2015 – 2016 në vleren 10000EUR | 2014<br><br>2015-2016 | 10000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | | **O5-** Mbështetja dhe subvencionimi me një vlere 100000 euro i ngritjes së kapaciteteve përpunuese të produkteve bujqësore deri në vitin 2016 | **A1:** Përcaktimi i produkteve bujqësore që do subvencionohen dhe kritereve të përzgjedhjes së përfituesve për përpunim të produkteve bujqësore<br><br>**A2:** Sensibilizimi i vazhdueshëm i opinionit për përpunimin e produkteve bujqësore (peme dhe perime) | **A1 – P1:** Ngritja e një qendre për përpunimin e pemëve dhe perimeve 2016 në vlere 350000<br><br>**A2 – P1:** Sensibilizimi i opinionit për funksionin e qendres përpunuese | 2016<br><br>2016 | 35000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | **Qellimi 5** Të krijohet një mjedis i favorshëm socio-kulturor, arsimor dhe ekologjik | **O1** Mbështetja dhe promovimi i 10 talenteve në vit për arritje të veçanta në arsim, kulturë dhe sport në | **A1:** Përcaktimi i kritereve dhe përzgjedhja e talenteve<br><br>**A2:** Promovimi i talenteve për fushat specifike | **A1 – P1:** Shpallja e konkursit për perzgjedhjen e talenteve<br><br>**A2 – P1:** Organizimi i ngjarjes për promovimin e talenteve | 2014<br><br>2014 | 1000<br><br>9000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vlerën 10000 euro | | | | |
| | | **O2-** Organizimi i festes "Dita e Luleve" si feste tradicionale vjetore e komunes | **A1:** Manifestimi i festes “Dita e Luleve” | **A1 – P1:** Shpallja dhe përgatitja e skenarit per organizimin e festes “Dita e Luleve<br><br>**A2 – P1:** Organizimi i festes “Dita e Luleve” | 2014<br><br>2014 | 3000 EUR<br><br>10000 |
| | | **O3-** Mbështetja çdo vit e 10 aktiviteteve te veçanta rinore, sportive dhe kulturore në vleren 60000 euro | **A1:** Percaktimi i kritereve dhe sensibilizimi i të rinjëve për tu marrë me aktivitete sportive, kulturore dhe edukative<br><br>**A2:** Përzgjedhja, mbeshtetja dhe promovimi i aktiviteteve te veqanta rinore, sportive, kulturore dhe edukative | **A1 – P1**: Sensibilizimi i të rinjeve për tu marre me aktivitete rinore (kulturore, sportive dhe edukative)<br><br>**A2 – P1:** Mbështetja dhe Promovimi i aktiviteteve te veqanta rinore (kulturore, sportive dhe edukative) | 2014<br><br>2014 | 5000 EUR<br><br>55000 EUR |
| | | **O4-** Sensibilizimi i përvitshëm i publikut dhe komunitetit të biznesit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit në vleren 50000 euro | **A1:** Vetëdijsimi i publikut dhe komunitetit te biznesit per mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit<br><br>**A2:** Mbështetja e OJQ-ve, aktiviteteve vullnetare dhe shkollave qe e promovojnë | **A1 – P1:** Organizimi i kampanjes per vetedijsimin e publikut, ne veqanti komunitetin e biznesit per mbrojtjen e mjedisit<br><br>**A2 –P1:** Mbështetja e aktiviteteve te cilat promovojne mbrojtjen e mjedisit<br><br>**A3 – P1:** Mbështetja e | 2014<br><br>2014 | 10000 EUR<br><br>20000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | mbrojtjen e mjedisit<br><br>**A3:** Mbështetja e ndërrimit të fushveprimtarise se bizneseve që e ndotin mjedisin (furra të gelqereve) | ndërrimit të fusheveprimtarise së bizneseve që e ndotin mjedisin | 2014 | 20000 EUR |
| | | **O5-** Mbështetja e bizneseve qe prodhojne energji alternative | **A1:** Studimi i fizibilitetit per prodhimin e energjise alternative<br><br>**A2:** Përcaktimi i kritereve dhe promovimi i prodhimit te energjise alternative nga bizneset<br><br>**A3:** Mbështetja e bizneseve qe pretendojne te prodhojne energji alternative | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit për prodhimin e energjisë alternative<br><br>**A2 – P1:** Promovimi i potencialeve të prodhimit të energjisë alternative<br><br>**A3 – P1:** Mbështetja e bizneseve qe pretendojne te prodhojne energji alternative | 2014<br><br>2014<br><br>2016 | 10000 EUR<br><br>2000 EUR |
| | **Qellimi 6** Të promovohet shfrytëzimi i burimeve natyrore | **O1-** Analiza e kapaciteteve aktuale të burimeve natyrore të komunës | **A1:** Studimi i fizibilitetit të burimeve natyrore<br><br>**A2:** Përcaktimi i zonave me burime të veçanta natyrore | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit<br><br>**A2 – P1:** Hartimi i planeve specifike për burime specifike natyrore | 2015<br><br>2016 | 10000 EUR<br>30000 EUR |
| | | **O2-** Percaktimi i zonave për shfrytezim të gurit dhe mineraleve si dhe caktimi i | **A1:** Përcaktimi i zonave dhe kritereve për shfrytezimin e gurit dhe mineraleve | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit per kapacitetet e gurit dhe mineraleve<br><br>**A2 – P1:** Hartimi i planit per shfrytezimin e zonave të gurit | 2016<br><br>2017 | 10000 EUR<br><br>15000 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kushteve për shfrytëzimin e tyre | **A2:** Hartimi i planit për shfrytezimin e zonave te gurit dhe mineraleve<br><br>**A3:** Sensibilizimi i opinionit per kapacitetet dhe zonat e shfrytezimit të gurit dhe mineraleve dhe kushtve per shfrytezimin e tyre | dhe mineraleve<br><br>**A3 – P1:** Promovimi i kapaciteteve te zonave per shfrytezimin e gurit përkatesisht mineraleve dhe kushteve per shfrytezimin e tyre | 2017 | EUR<br><br>5000 EUR |
| | | **O3-** Përcaktimi i zonave per prodhimin e energjise, ujit të pishem dhe kultivimin e peshkut | **A1:** Përcaktimi i zonave për prodhimin e energjisë hidrike<br><br>**A2:** Percaktimi i zonave per prodhimin e ujit të pijshem<br><br>**A3:** Përcaktimi i zonave për kultivimin e peshkut<br><br>**A4:** Hartimi i planeve te zonave specifike | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit për prodhimin e energjise hidrike, ujit te pijshem dhe kultivimin e peshkut<br><br>**A4 – P1:** Hartimi i planeve specifike rregulluese per prodhimin e energjise, hidrike, ujit te pijshem dhe kultivimin e peshkut<br><br>**A5 – P1:** Promovimi i kapaciteteve dhe zonave per prodhimin e energjise, hidrike, ujit te pijshem dhe kultivimin e peshkut | 2016<br><br>2017<br><br>2017 | 10000 EUR per secilen<br><br>20000 EUR<br><br>10000 EUR |
| | | **O4-** Eksplorimi, konservimi, promovimi dhe funksionalizimi i bukurive natyrore dhe gjurmeve te trashegimise historike… | **A1:** Analiza e kapaciteteve te bukurive natyrore dhe trashegimise historike<br><br>**A2:** Hartimi i planit te eksplorimit, konservimit dhe shfrytezimit/funksionalizimit te bukurive natyrore dhe te gjurmeve te trashegimise historike | **A1 – P1:** Studim i fizibilitetit te bukurive natyrore dhe trashegimise historike, 2016 ne vlere prej 10000EUR<br><br>**A1 – P2:** Shpallja e objekteve dhe zonave te veqanta historike/natyrore, 2016<br><br>**A2 – P1:** Hartimi i planeve specifike te eksplorimit, konservimit dhe shfrytezimit/funksionalizimit te bukurive natyrore dhe te gjurmeve te trashegimise | 2016<br><br>2016<br><br>2017 | 10000 EUR<br><br>20000 EUR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | historike | | |
| | | | **A3:** Promovimi i bukurive natyrore dhe gjurmeve te trashegimise historike | **A3 – P1:** Organizimi i fushates per promovimin e bukurive natyrore dhe gjurmeve te trashegimise historike | 2017 | 5000 EUR |
| | | | **A4:** Funksionalizimi i bukurive natyrore dhe gjurmeve te trashegimise historike | **A4 – P1:** Shpallja e shprehjes per interesim per funksionalizimin e bukurive natyrore dhe gjurmeve te trashegimise historike | 2017 | 5000 EUR |
| | | **O5-** Promovimi dhe shfrytezimi i nje zone pyjore per gjueti dhe krijimi i dy rezervateve per kultivimin dhe rritjen e kafsheve te egra deri ne vitin 2018 | **A1:** Studimi i fizibilitetit per krijimin e dy rezervateve | **A1 – P1:** Studimi i fizibilitetit per krijimin e dy rezervateve dhe zones se pyjeve per gjueti, | 2016 | 10000 EUR |
| | | | **A2:** Hartimi i planit per shfrytezimin e zones se pyjeve per gjueti | **A2 – P1:** Hartimi i planit per shfrytezimin e zones se pyjeve per gjueti dhe per shfrytezimin e dy rezervateve specifike | 2017 | 20000 EUR |
| | | | **A3:** Hartimi i planit per shfrytezimin e dy rezervateve specifike | **A3 – P1:** Shpallja dhe promovimi i zonave per dy rezervate per kultivimin dhe rritjen e kafsheve, 2017 ne vlere prej 5000EUR | 2017 | 5000 EUR |
| | | | A4: Promovimi i zones së pyjeve per gjueti dhe rezervateve specifike | | | |
| | | | **A5:** Funksionalizimi i dy rezervateve specifike dhe zonës se pyjeve per gjueti | **A5 – P1:** Shpallja e shprehjes për interesim per funksionalizimin e dy rezervateve specifike dhe zones se pyjeve per gjueti | 2017 | 5000 EUR |

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal për periudhën 2014 – 2018, është aprovuar në Kuvendin Komunal-Shtime më datën: 18.09.2013, Duke pasë për bazë nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 14 dhe 15 të Statutit të Komunës së Shtimes, mbi bazën e diskutimeve me qytetarë, punës të grupit punues për hartimin e strategjisë në bashkpunim me kompanin e specializuar “Instituti Kosovar për Menaxhim” – Prishtinë, si dhe Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Kujtim Xhelili**

**v.v.** ___________________________